



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-9920/23 datë:19.04.2023



Npi – 01/160 datë: 27.04.2023

Duke u bazuar në nenin, 12.2 pika (d), 81.1 pika (a), 81.2, dhe 82.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); Nenin 5.1, 9.4 dhe 9.5 të Rregullores të (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave; Rregulloren e (MAPL) Nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës; Si dhe duke u bazuar në kërkesën e Ministrisë të Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës Nr.1534-2/23 të datës 03.04.2023 për rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/81, dt. 15.03.2023, për miratimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027. Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e rregullt, të mbajtur më datën: 27.04.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR KORRIXHIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
Npi-01/81 SIPAS REKOMANDIMIT TË MMPHI-së

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IV- të rregullt për vitin 2023, të mbajtur më: 27.04.2023, unanimisht miratoi, korrixhimin e bazës Ligjore të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/81, dt. 15.03.2023, për miratimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027, si vijon:

- Bazuar në nenin 12 pikat 12.1 dhe 12.2. shkronja (d), nenin 17 shkronja (f), nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008);
- Nenin 8 pika 1.3, nenin 10 pikat 2, 6, dhe 7, nenin 13 pika 1.2, dhe nenin 15 të Ligjit për Mbeturina Nr.04/L-060; Si dhe Ligjit Nr.08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit, Nr.04/L-060 për Mbeturina;
- Nenin 5, pika 3, nënpika 3.5 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.50/2009);
- Nenin 2, pika 1.5 të Ligjit për Partneritet Publiko-Privat Nr.04/L-045 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.26/2011);
- Neni 5 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636, të datës 03.09.2008;
- Rregulloren e MAPL-së Nr.02/2021, për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës;

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi